

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-182/14

Prishtinë,
20 korrik 2016

Në çështjen juridike të:

D.T.B.

Rr. "Aleksandra Veljkovića" nr. 7/1

Jagodinë

Serbi

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, gjyqtarët Krassimir Mazgalov dhe Beshir Sylejmani anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (tani e tutje KKPK) nr. KPPC/D/A/212/2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA25880), të datës 21 gusht 2013 (tani e tutje: vendimi i kontestuar i KKPK-së), pas shqyrtimit të mbajtur më 20 korrik 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga D.T.B. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPPC/D/A/212/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA25880) të datës 21 gusht 2013, refuzohet si e pabazuar.

2. **Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPPC/D/A/212/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA25880) i datës 21 gusht 2013, vërtetohet.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 14 tetor 2007, D.T.B. (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (tani e tutje: AKP) si anëtar i bashkësisë familjare (ABF) përkatësisht babait të tij të ndjerë T.M.B. (tani e tutje: bartësi i së drejtës pronësore) me të cilën ka kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore mbi ngastrën nr. 8, me sipërfaqe prej 0He 3Ar 62m², Zona Kadastrale Pejë, Komuna e Pejës (tani e tutje: prona e kërkuar).
2. Në kërkesë pala ankuese pretendon se pronën e kërkuar e kishte humbur për shkak të rrethanave të lidhura me konfliktin e armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë më 1998/99, duke e treguar datën 13 qershor 1999 si datë të humbjes së pronës.
3. Bashkë me kërkesën e tij, pala ankuese në mes tjerash në AKP ka paraqitur:
 - Kontratën e blerjes, të lidhur më 23 maj 1960 në mes të shitësit N.R. dhe blerësit bartësit të së drejtës pronësore (tani e tutje: BDP). Në këtë dokument nuk specifikohet numri i fletës poseduese dhe/apo i ndonjë ngastre;
 - Fletën poseduese nr. 25, të lëshuar nga Zyra kadastrale e Komunës së Pejës më 31 gusht 1994, duke e cilësuar BDP-në si pronar të pronës së kërkuar;
 - Certifikatën e vdekjes së BDP-së nr. 200-3/000SL/98 të lëshuar nga Komuna e Pejës, Republika e Serbisë më 7 prill 1998;
 - Autorizimin e dhënë nga pala ankuese në emër Z.B. për ta përfaqësuar atë pranë AKP-së.
4. Njoftimi i kërkesës është bërë përmes publikimit në gazetën e AKP-së për njoftime (nr. 1 dhe 11) dhe Buletinin e Zyrës së Pronës të UNHCR-së, më 28 maj 2010 dhe 25 prill 2013.
5. Pas njoftimeve të kërkesës dhe brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, askush nuk është paraqitur si palë përgjegjëse në kërkesë apo palë me interes pranë AKP-së/KKPK-së, prandaj AKP-ja/KKPK-ja e ka trajtuar kërkesë si jokontestuese.

6. Në bazë të raportit të verifikimit të AKP-së të datës 5 mars dhe 10 qershor 2008 si dhe raportit të konsoliduar të verifikimit të datës 18 janar 2013, dokumentet e dorëzuara (përveç certifikatës së vdekjes së BDP-së dhe letërnjoftimit të palës ankuese të verifikuar *prima facie*) nuk janë gjetur në Departamentin e Kadastrit të Komunës së Pejës dhe në Gjykatën Komunale të Pejës.
7. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka kontaktuar palën ankuese më 5 gusht 2009 (ai gjithashtu është kontaktuar edhe më parë) dhe ka kërkuar dokumentacion shtesë, mirëpo ai nuk i ka siguruar asnjërën nga ato.
8. Më 21 gusht 2013, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/212/2013 ka refuzuar kërkesën. Në paragrafët 102-103 të arsyetimit të vendimit, KKPK-ja thekson se kontrata e blerjes e dorëzuar nga pala ankuese, e lidhur në vitin 1960 në mes të BDP-së si blerës dhe N.R. si shitës nuk e identifikon pronën e kërkuar. Në të njëjtin vendim është theksuar se fleta poseduese e vitit 1994 nga zyra e zhvendosur e kadastrit e dorëzuar nga pala ankuese në të cilën BDP figuron si pronar i ligjshëm i pronës së kërkuar nuk ka mundur të verifikohet si e vërtetë. Vendimi në fjalë gjithashtu thekson se Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së (tani e tutje: SE) sipas detyrës zyrtare ka gjetur një fletë poseduese të azhurnuar të vitit 2008, në të cilën prona e kërkuar figuron në emër të Komunës së Pejës. Më tutje, KKPK-ja thekson se SE-ja ka kontaktuar palën ankuese disa herë dhe ka kërkuar nga ai që të paraqes dokumente plotësuese për të vërtetuar të drejtën e pretenduar pronësore mbi pronën e kërkuar, mirëpo ai ka deklaruar se nuk ka asnjë provë tjetër për ta paraqitur.
Përfundimisht, KKPK-ja konstaton se pala ankuese ka dështuar që të vërtetojë pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar pak para apo gjatë konfliktit të vitit 1998-1999.

Pretendimet e palës ankuese:

9. Në ankesë, pala ankuese pretendon se vendimi i kontestuar i KKPK-së është bazuar në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe në zbatim të gabuar të ligjit material.
10. Pala ankuese pretendon se konstatimi i KKPK-së se SE-ja nuk ka mundur t'i verifikoj asnjërin nga dokumentet e dorëzuara është i pavërtetë. Sipas tij, institucionet përgjegjëse

për verifikim i kanë në posedim provat në bazë të të cilave do të mund të konfirmonin se dokumentet e paraqitura janë të vërteta.

11. Pala ankuese gjithashtu pohon se ai asnjëherë nuk e ka paraqitur fletën poseduese (të përmendur në vendimin e KKPK-së) për të cilën pretendohet se SE-ja ka gjetur se prona e kërkuar figuron në emër të palës së tretë.
12. Sipas palës ankuese, provat e paraqitura në mënyrë të qartë vërtetojnë se BDP ka qenë pronar i ligjshëm dhe posedues i pronës së kërkuar dhe se këtë të drejtë e ka humbur për shkak të rrethanave të cilat kanë ndodhur si rezultat i konfliktit të armatosur i cili ka ndodhur në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
13. Përfundimisht, pala ankuese i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që ta aprovojë ankesën e tij dhe të vërtetojë se (pala ankuese) e ka të drejtën për ri-posedim të pronës së kërkuar.

Arsyetimi ligjor:

14. Ankesa është e pranueshme. Është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç është përcaktuar me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale (tani e tutje: Ligji nr. 03/L-079).
15. Vendimi i kontestuar i KKPK-së bazohet në faktin se SE-ja dhe KKPK-ja kishin bërë verifikim negativ të dokumenteve mbi të cilat pala ankuese e bazon pretendimin e pronësisë. SE-ja sipas detyrës zyrtare ka siguruar fletën poseduese nr. 25 të lëshuar nga Departamenti i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës i Komunës së Pejës, në të cilën prona e kërkuar figuron në pronësi të Komunës së Pejës.
Për më tepër, SE-ja disa herë ka kontaktuar (31 mars, 3 qershor dhe 18 dhjetor 2008, dhe 5 gusht 2009), palën ankuese dhe i ka kërkuar që të paraqes dokumente shtesë për të vërtetuar të drejtën e pretenduar pronësore, mirëpo ai nuk ka paraqitur asnjëherë nga to.
16. Në ankesën e palës ankuese përsëriten pretendimet e njëjta të cilat anë paraqitur pranë KKPK-së. Nuk është paraqitur asnjë provë e re me ankesë.

17. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë të bazuar në procedurë korrekte dhe të hollësishme. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme nuk gjen asnjë shkelje të ligjit material apo vërtetim jo të plotë të fakteve. Gjykata Supreme gjen se ankesa është a pabazuar.
18. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në bazë të nenit 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në pajtim me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, gjyqtar

Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it